



### **VENDIM**

*Nr. 109, Datë 21.10.2011*

### **PËR**

### **MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI**

### **ELEKTRIKE TË KLIENTËVE JO-FAMILJARË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128, të Ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative“, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 21.10.2011, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës,

### **Vendosi:**

1. Të miratojë kontratën e furnizimit me energji elektrike të klientëve jo-familjarë (Kontrata, bashkelidhur ketij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Cez Shpërndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
  
3. Kjo kontratë hyn në fuqi në 1 Janar 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**